



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I BASHKIAK PUKE

Nr.1236 Prot

Pukë, më 13.08.2026

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

TITULLI: KONSULTIM PUBLIK PËR REFORMËN ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE 2.0

PROPOZUESI I PROJEKT-AKTIT: Kryetari i Bashkisë Pukë

QËLLIMI: Ky bashkëbisedim me banorët, grupet e synuara të interesit dhe grupet e marginalizuara të Bashkisë Pukë ka për qëllim mbledhjen e sugjerimeve, mendimeve dhe rekomandimeve të komunitetit lidhur me propozimet e Reformës Administrativo-Territoriale 2.0.

KALENDARI I KONSULTIMIT

Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet sipas kalendarit të mëposhtëm:

Nr	Njësia Administrative	Data	Ora	Vendi
1	Gjegjan	03.09.2026	10:00	Njësia Administrative
2	Rrape	03.09.2026	12:00	Njësia Administrative
3	Qerret	04.09.2026	10:00	Njësia Administrative
4	Qelëz	04.09.2026	12:00	Njësia Administrative
5	Pukë	07.09.202	10:00	Salla embledhjeve të Këshillit

Gjithashtu, sugjerimet, komentet dhe rekomandimet e qytetarëve janë të mirëpritura deri më datë 08.09.2026, në adresën elektronike: **E-mail:** bashkiapuke@yahoo.com

PJESËMARRËS

Nga ana e Bashkisë Pukë:

- ✓ Këshilltarët e Këshillit Bashkiak;
- ✓ Kryetari, nënkryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë;
- ✓ Sekretari i Këshillit Bashkiak;
- ✓ Koordinatorin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik;
- ✓ drejtues dhe punonjës të administratës së Bashkisë;
- ✓ drejtuesit e strukturave dhe njësive administrative;
- ✓ kryetarët e fshatrave;
- ✓ përfaqësues të strukturave të shërbimeve publike;
- ✓ përfaqësues të institucioneve vendore.
- ✓ Nga komuniteti:
- ✓ banorët e Bashkisë Pukë;
- ✓ përfaqësues të shoqërisë civile;

- ✓ përfaqësues të biznesit;
- ✓ përfaqësues të medias;
- ✓ përfaqësues të komuniteteve dhe grupeve të interesit;
- ✓ përfaqësues të grupeve të marginalizuara;
- ✓ kryetarë të fshatrave dhe përfaqësues të komuniteteve lokale;
- ✓ çdo qytetar i interesuar.

FORMA E KONSULTIMIT

Takime publike në terren.

Qëllimi i këshillimit publik

Konsultimi publik në terren synon informimin e komunitetit dhe marrjen e mendimit të qytetarëve të Bashkisë Pukë lidhur me propozimet e Reformës Administrativo-Territoriale 2.0.

PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES

Reforma Administrativo-Territoriale 2.0 synon rishikimin e organizimit administrativo-territorial të vendit dhe të mënyrës së organizimit të njësive të qeverisjes vendore.

Në kuadër të këtij procesi, konsultimi publik synon të mundësojë që qytetarët dhe komunitetet lokale të shprehin qëndrimin e tyre mbi ndryshimet e propozuara, duke paraqitur mendimet, shqetësimet, vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me:

- ✓ përfaqësimin e komunitetit;
- ✓ aksesin dhe cilësinë e shërbimeve publike;
- ✓ afërsinë e administratës me qytetarët;
- ✓ zhvillimin ekonomik dhe social të territorit;
- ✓ infrastrukturën dhe lidhjet territoriale;
- ✓ ruajtjen e identitetit dhe veçorive të komunitetit;
- ✓ nevojat specifike të zonave malore;
- ✓ perspektivën e zhvillimit të Bashkisë Pukë;
- ✓ çdo alternativë tjetër të mundshme lidhur me riorganizimin administrativo-territorial.

Mendimi i komunitetit do të jetë një element i rëndësishëm në vlerësimin e propozimeve dhe në procesin e vendimmarrjes lidhur me riorganizimin e hartës administrativo-territoriale.

KONTAKTET DHE AFATET E DËRGIMIT TË KOMENTEVE, REKOMANDIMEVE DHE VËREJTJEVE

Komentet, rekomandimet dhe vërejtjet mund të paraqiten gjatë takimeve publike ose të dërgohen me shkrim pranë Bashkisë Pukë dhe Këshillit Bashkiak Pukë, brenda datës 08.09.2026.

E-mail: bashkiapuke@yahoo.com

NDRYSHIMET KRYESORE DHE/OSE ALTERNATIVAT E MUNDSHME

Alternativat dhe propozimet e mundshme do të shqyrtohen nga Bashkia Pukë dhe Këshilli Bashkiak Pukë, në përputhje me mendimet dhe rekomandimet e komunitetit dhe materialet e paraqitura në kuadër të Reformës Administrativo-Territoriale 2.0.

MATERIALET E KONSULTIMIT

Materialet dhe relacionet për konsultimin me publikun do të jenë të aksesueshme pranë Bashkisë Pukë dhe në kanalet zyrtare të informimit të Bashkisë.

PROCESI PAS KONSULTIMIT PUBLIK

Pas mbledhjes së rekomandimeve dhe mendimeve të komunitetit, Këshilli Bashkiak Pukë do të ndjekë këto hapa:

1. Sekretariati i Këshillit Bashkiak do të përgatisë një përmbledhje të rekomandimeve dhe rezultateve të konsultimeve publike.
2. Përmbledhja do t'i përcillet Kryetarit të Bashkisë, komisioneve të Këshillit Bashkiak dhe këshilltarëve bashkiakë.
3. Komisionet përkatëse të Këshillit Bashkiak do të shqyrtojnë rekomandimet e paraqitura nga komuniteti.
4. Do të vlerësohen propozimet dhe alternativat lidhur me Reformën Administrativo-Territoriale 2.0.
5. Çështja do të diskutohet në një mbledhje të hapur të Këshillit Bashkiak.
6. Komuniteti do të informohet mbi rekomandimet e marra në konsideratë dhe ato që nuk janë marrë në konsideratë, së bashku me arsyet përkatëse.
7. Dokumentacioni përfundimtar do të publikohet në kanalet zyrtare të Bashkisë/Këshillit Bashkiak.
8. Qëndrimi i Bashkisë Pukë dhe Këshillit Bashkiak Pukë do t'u përcillet institucioneve kompetente në kuadër të procesit të Reformës Administrativo-Territoriale 2.0.

**KRYETARI I KËSHILLIT
GJON GJOKA**

